



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 12

7 shkurt 2026

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10:00 dhe mbaron në orën 13:00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....

2.....

1. Urbanizimi është procesi në të cilin gjithnjë e më shumë njerëz fillojnë të jetojnë dhe të punojnë në qytete.

a) Cilat janë aspektet e jetës urbane që shërbejnë si bazë për qytetet inteligjente. **2 pikë**

Aspektet e ndryshme të jetës urbane që zakonisht janë baza e qyteteve inteligjente janë ekonomia, mjedisi, qeverisja, kapitali njerëzor, lidhjet ndërkombëtare, lëvizshmëria dhe transporti, menaxhimi publik, kohezioni social, teknologjia dhe planifikimi urban.)

b) Çfarë kuptoni me “Qytete të zgjuara” ose “Smart City”? **2 pikë**

“Qytetet e zgjuara” janë rajone urbane që janë shumë të avancuara në aspektin e infrastrukturës së përgjithshme, pronës së qëndrueshme, komunikimeve dhe aftësisë për treg. Qëllimi kryesor i një qyteti të zgjuar është të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të nxisë rritjen ekonomike.

c) Analizoni përmes shembujve se si ndikon në mjedisin e nivelin e lartë të urbanizimit. **3 pikë**

Me rritjen e urbanizimit, mjedisi ndikohet në shumë mënyra si:- Ka një rritje të fortë të ndotjes së ajrit për shkak të më shumë fabrikave dhe mjeteve motorike që qarkullojnë nëpër rrugë.

- Zgjerimi i qyteteve çon në shkatërrimin e florës dhe faunës. Kërkesa për më shumë banesa çon në shpyllëzim dhe shkatërrimin e zonave të lagështa, të cilat llogojnë shumë zogj dhe kafshë nga habitatet e tyre natyrore.
- Në shumë zona pranë detit, urbanizimi dëmton ekosistemin e oqeanit.
- Shkatërrimi i zonave të gjelbra dhe rritja e ndërtesave çon në rritjen e temperaturave të qytetit
- Rritja e ndotjes së ajrit çon në sëmundje të frymëmarrjes dhe alergji, etj.)

d) Shpjegoni se si ndikon mbipopullimi në aspektin social, ekonomik dhe atë mjedisor në një hapësirë të caktuar gjeografike. **3 pikë**

Ndikimi social:

Nuk ka ushqim, strehim dhe arsim të përballueshëm. Njerëzit jetojnë në zona të mbipopulluara me kushte të dobëta sanitare që çojnë në përhapje sëmundjesh, varfëri dhe rritje të kriminalitetit.)

Ndikimi në ekonomi:

Popullsia më e madhe çon në papunësi, mbipopullim, mungesë ushqimi, karburanti, mineraleve dhe burimeve të tjera. Kjo çon në cilësi të dobët të arsimit, të ardhura të ulëta për frymë, inflacion, më pak produktivitet dhe rritje të ngadaltë ekonomike të vendit.

Ndikim në mjedis:

Popullsia më e madhe konsumon më shumë burime natyrore si ujin e pijshëm, toka e punueshme dhe burimet minerale. Kjo çon në shpyllëzim, mungesë uji, zhdukjen e bimësisë dhe kafshëve, shterimin e lëndëve djegëse fosile, ndotje, ngrohje globale.

2. Shumë vende në mbarë botën, përfshirë Kanadanë, kanë më shumë se një gjuhë zyrtare.

Kanada



- a) Identifikoni zonën e hijezuar në hartë dhe gjuhën kryesore që flitet nga shumica e banorëve.

2 pikë

Në Kanada, zona e hijezuar në shumicën e hartave që i referohen dygjuhësisë është Quebecu dhe gjuha kryesore që flitet nga shumica e banorëve në Quebec është frëngjishtja.

- b) Shpjegoni përmes tri treguesve se si dygjuhësia mund të ketë ndikim pozitiv në një vend.

3 pikë

- *Pasuri kulturore*: Në Kanada flitet dhe anglishtja por frëngjishtja mbizotëron si gjuha amtare dhe gjuha kulturore e shumicës së popullsisë. Kjo *pasuri kulturore* e dygjuhësi lejon ruajtjen dhe festimin e disa identiteteve kulturore brenda një vendi.
- *Konkurrenca globale*: Qytetarët që flasin më shumë se një gjuhë mund të angazhohen në mënyrë efektive në tregti ndërkombëtare, diplomaci dhe turizëm.
- *Kohezioni shoqëror përmes përfshirjes*: Njohja e disa gjuhëve mund të bëjë që grupet minoritare të ndihen të respektuara dhe të përfshira, duke reduktuar marginalizimin.
- *Përfitimet arsimore*: Individët me përdorim dygjuhësh shpesh zhvillojnë aftësi njohëse më të forta, si zgjidhja e problemeve.
- *Etj.*

- c) Shpjegoni përmes tri treguesve se si dygjuhësia mund të ketë një ndikim negativ në një vend.

3 pikë

- *Tension politik*: Grupet gjuhësore që konkurrojnë mund të çojnë në ndarje.
- *Kosto administrative*: Ofrimi i shërbimeve qeveritare, arsimit dhe dokumenteve ligjore në gjuhë të ndryshme rrit shpenzimet.
- *Konflikte identiteti*: Qytetarët mund të ndihen nën presion për t'u asimiluar në një grup gjuhësor dominant, duke krijuar fërkime sociale.
- *Ndarjet rajonale*: Diferencat gjuhësore mund të forcojnë ndarjet gjeografike dhe kulturore brenda vendit.
- *Etj.*

- d) Evidentoni dy arsye pse Kanadaja nuk mund të përshtatet me konceptin e shtetit kombëtar të unifikuar (përveç gjuhës).

2 pikë

- *Popullsia multikulturore* që do të thotë se Kanadaja është shumë e larmishme, me komunitete të rëndësishme të emigrantëve nga Azia, Evropa, Afrika dhe Lindja e Mesme. Kjo larmishmëri do të thotë që Kanadaja nuk është një "komb" homogjen i vetëm, por më tepër një mozaik i etnive dhe kulturave.
- *Popujt indigjenë*: Kanadaja është shtëpi për komunitetet e First Nations, Inuit dhe Metis, secili prej tyre me identitete, tradita dhe struktura qeverisëse të veçanta. Prania dhe njohja e tyre sfidon idenë e Kanadasë si një shtet kombëtar i unifikuar me një identitet dominues.

3. Evropa Perëndimore është një ndër rajonet më të zhvilluara të botës, me një shtrirje të kufizuar territoriale, por me peshë të madhe demografike dhe ekonomike në shkallë globale. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën e organizimit të hapësirës dhe zhvillimin rajonal.

- a) Përshkruani veçoritë kryesore të relievit, klimës dhe rrjetin hidrografik si dhe ndikimin e tyre në aktivitetet njerëzore të rajonit Evropa Perëndimore.

3 pikë

Relievi i rajonit Evropa Perëndimore është i larmishëm, mbizotëron relievi fushor, fusha më e madhe e rajoni është Ultësira e Francës dhe Gjermanisë Veriore. Relievi malor shtrihet kryesisht në pjesën jugore të rajonit me Alpet e Evropës dhe Masivin francez. Relievi kryesisht fushor ka ndikuar shumë pozitivisht në popullimin dhe zhvillimin ekonomik të rajonit.

Klima kryesisht është oqeanike, me reshje të shpërndara gjatë vitit dhe temperatura mesatare, e ndikuar nga Rryma e Gjirit në Perëndim dhe kontinentale në Lindje të rajonit.

Rrjeti lumor është mjaft i dendur me lumenj të mëdhenj dhe të lundrueshëm (Reni, Sena, Loara, Elba), që kanë favorizuar bujqësinë, transportin dhe zhvillimin e qyteteve.

- b) Analizoni veçoritë demografike të Evropës Perëndimore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të rajonit.

5 pikë

- Rajoni i Evropës Perëndimore dallohet për dendësi të lartë të popullsisë.
- Popullsia është e përqendruar kryesisht në ultësira, lugina lumenjsh dhe zona urbane-industriale.
- Popullsia e rajonit është prekur nga dukuria e plakjes së popullsisë, por me fuqi punëtore të kualifikuara dhe migracion që kompenson mungesat.
- Fuqia punëtore e kualifikuara dhe tregu i madh konsumator kanë favorizuar industrializimin e hershëm dhe të avancuar të rajonit.
- Rajoni dallohet për nivel shumë të lartë urbanizimi; qytete të mëdha si Londra, Parisi, Berlina janë qendra ekonomike dhe financiare.
- Dominimi i shërbimeve të tilla si: financë, teknologji, transport, turizëm etj., lidhet ngushtë me përqendrimin urban dhe kapitalin njerëzor të Evropës Perëndimore.

- c) Vlerësoni rolin e Evropës Perëndimore në ekonominë botërore, duke dhënë dy argumente kryesore që lidhen me tregtinë, teknologjinë ose integrimin ekonomik.

2 pikë

- Evropa Perëndimore është një nga qendrat kryesore të tregtisë botërore, dy shtetet më të zhvilluara të saj Gjermania dhe Franca përbëjnë bërthamën e Bashkësisë Evropiane
- Ekonomia e Evropës Perëndimore realizon një prodhim të përgjithshëm të mbështetur në teknologji moderne dhe të sofistikuar. Rajoni gjithashtu është lider në inovacion, industri të avancuara dhe shërbime financiare globale.
- Etj.

4. Shkruani një ese argumentuese me temë: "Pozita gjeografike dhe pasuritë natyrore: faktorë kyç në rendin e ri botëror". **10 pikë**

Eseja do të vlerësohet për këto aspekte:

Fokusi i esesë:

- Ndikimi i pozitës gjeografike të një vendi ndikon në fuqinë ekonomike, politike dhe ushtarake.
- Rëndësia e qasjeve në det, rrugëve tregtare dhe kufijve strategjikë.
- Ndikimi i burimeve natyrore (nafta, gazi natyror, mineralet etj.) në vendosjen e vendit në hartën globale të fuqisë.
- Shembuj konkretë të vendeve të ndryshme.

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese argumentuese me temë: “E ardhmja e Bashkimit Evropian: sfidat dhe mundësitë në shekullin XXI”. **10 pikë**

Eseja do të vlerësohet për këto aspekte:

Fokusi i esesë:

- Integrimi ekonomik dhe tregtar – si mund të forcohet ekonomia e përbashkët dhe tregu i brendshëm.
- Politikat e jashtme dhe siguria – roli i BE-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mbrojtjen e paqes në rajon.
- Çështjet sociale dhe migracioni – sfidat e integritit të popullsisë, punësimit dhe sistemit social.
- Ndryshimet klimatike dhe energjia – roli i BE-së në energjinë e rinovueshme dhe ruajtjen e mjedisit.
- Zgjerimi dhe bashkëpunimi rajonal – mundësitë dhe sfidat e pranimit të vendeve të reja dhe forcimit të lidhjeve me fqinjët.
- Përballimi i sfidave globale

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.